

NJOFTIM
Nr. 22192, datë 7.12.2023

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË
INSTITUTIT TË PËRGATITJES SË QENVE TË POLICISË, TIRANË**

Në zbatim të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III, shpall për shitje me VAM të ulur, si më poshtë:

1. Në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë

Nr.	Emërtimi	Datëlindja	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lek	Zhvillimi i ankandit		
					Data	Ora	Vendi
1	Qeni Rudi	3.10.2013	Tiranë	4,000	4.1.2024	11:00	DPSH
2	Qeni Piku	24.11.2013	Tiranë	4,000	4.1.2024	11:15	DPSH
3	Qeni Tana	15.9.2012	Tiranë	4,000	4.1.2024	11:30	DPSH
4	Qeni Ina	15.6.2013	Tiranë	4,000	4.1.2024	11:45	DPSH
5	Qeni Fiksi	17.3.2012	Tiranë	4,000	4.1.2024	12:00	DPSH
6	Qeni Petra	1.3.2013	Tiranë	4,000	4.1.2024	12:15	DPSH
7	Qeni Ysta	1.3.2013	Tiranë	4,000	4.1.2024	12:30	DPSH
8	Qeni Asta	16.6.2021	Tiranë	10,000	4.1.2024	12:45	DPSH

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerje e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Garancinë bankare apo mandatpagesën në origjinal, që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit në lek, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare apo mandatpagesa duhet të bëhet detyruesisht brenda afatit të pranimi të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandatpagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DPSH-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë:
www.financa.gov.al.